



100 vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



VENDIM

Nr. 129 Datë 11.09.2012

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “CEZ SHPËRNDARJE”
SHA, PËR MIRATIMIN E NJË MARRËVESHJE HIPOTEKORE
NDËRMJET CEZ SHPËRNDARJE SH.A. DHE *BANKËS EUROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD) DHE KORPORATËS
FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFC), NE KUADËR TË HUASË
BANKARE PREJ 100 MILION EURO TE MARRE NGA KOMPANIA
“CEZ SHPËRNDARJE” SHA.***

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika “1”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7, 11, pika 1 germa a), c) dhe d), të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Liçensuarit, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.09.2012, mbasi shqyrtoi kërkesën për lënien peng të asetëve si kolateral nga shoqëria “CEZ Shpërndarje” sh.a pranë bankave IFC/EBRD, si dhe relacionin e grupit të punës,

Vendosi :

1. Refuzimin e kërkesës së shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sha, për miratimin e një marrëveshje hipotekore ndërmjet CEZ Shpërndarje Sh.a. dhe *Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC), ne kuadër të huasë bankare prej 100 milion Euro te marre nga kompania “CEZ Shpërndarje” sha.*

2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.